

# PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE

Drejtuar: AKM-TIRANË

Për dijeni: DRM Berat-Korçë-Elbasan

Kërkesë për pjesëmarrje në organizimin e konsultimit me publikun dhe palët e interesuara për aplikimin për Leje Mjedisi Tipi B



“Veprimtaritë e katranit dhe të bitumit”, ID:7.3/c Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi.

SUBEKTI: “FLED”SH.P.K.

ADMINISTRATOR: Fredi MARRA

VENDNDODHJA E INSTALIMIT: FSHATI RRETH TAPI, NJ.A. PERONDI, BASHKIA KUÇOVË, ZONA KADASTRALE NR.3227, NR. PASURIE 83/2, QARKU BERAT



Ekspert mjedisi: Ledjana BOJAXHI

## 1. PROFILI I OPERATORIT

Shoqëria “Fled”shpk e regjistruar pranë QKB me nr. NIPT K17621104C, e themeluar më datë 02.11.2001, me administrator z. Ferdi Marra dhe me seli në Bashkinë Kuçovë, lagjja “Havaleas”, kërkon të pajiset me leje mjedisi të tipit B për të ushtruar aktivitetin që klasifikohet sipas ligjit të lejeve të mjedisit, në kategorinë “Veprimtari të katranit dhe bitumit”, konkretisht sipas kodit ID 7.3/c, që përfshin procese të ngrohjes dhe përpunimit të bitumit në funksion të prodhimit të materialeve ndërtimore, pa përfshirë proceset e distilimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
DENDRA KOMËRTARE & BIZNESIT

### EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

#### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	K17621104C
2. Data e Regjistrimit	02/11/2001
3. Emri i Subjektit	FLED
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	07/09/2001
6. Kohëzgjatja	Nga: 07/09/2001
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Berat Kozare HAVALEHAS Lagjja "Havaleas", rruga Ura e kozares Kuçovë, godinë private 1- katëshe, Nr 307.
8. Kapitali	8.241.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	8.241,00
9. Objekti i aktivitetit	Zbatim i punimeve të ndërtimit, punim dheu, murature, beton armë, punime shembje, sisteme, etj. Ndërtim rruge, vepra arti, kanalizime, ndërtim gazsjellës, godina civile, etj. Punime në sipërfaqet e gjelbërta, prodhim materiale inertë, etj, ndërtime detare, punime thëllimi në porte, etj. Punime të montimit në impiantet e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë, linja të TL, TU dhe të mesëm, aparatura teknike dhe mbështetëse të tyre. Prodhime druri, metalike. Tregti me pakicë të pjesëve të këmbimit për makineri e pajisje, shërbime në montim dhe montim të pajisjeve dhe makineri industriale, vajra, graso. Import -eksport. Transport rrugor të inerteve të ndërtimit si dhe mallrave të ndryshëm për të tretë brenda dhe jashtë vendit. Shërbime konsulence, shërbime topografike dhe shërbime vlerësime. Punime gjelbërimi, pastrime të qyteteve, zonave bregdetare, shërbime në varreza publike dhe dekoce. Grumbullim, përpunim i mbetjeve urbane. Prodhim dhe tregtimi i farave dhe fidaneve. Shërbime të ekspertizës profesionale lidhur me pyje dhe kullota. Pastrim dhe higjienizim të rrugëve dhe heqja e

1



## 2. VENDNDODHJA E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT

Projekti parashikon vendosjen e një impianti të përkohshëm për prodhimin e asfaltbetonit në fshatin Rreth Tapi, Njësia Administrative Perondi, Bashkia Kuçovë, Qarku Berat, në zonën kadastrale nr. 3227, pasuria nr. 83/2.

Zona ku do të realizohet projekti është e karakterit industrial dhe ekonomik, e përcaktuar si e tillë nga instrumentet e planifikimit vendor. Territori nuk përfshihet në zona të mbrojtura mjedisore, nuk ndikon në habitate natyrore të ndjeshme dhe nuk prek objekte të trashëgimisë kulturore apo historike.

KORDINATAT SIPAS ALBANIAN 1986- GAUSS KRUGER 04		
Prona	4405135.745	4520291.361
	4405163.771	4520280.154
	4405117.646	4520155.541
	4405092.689	4520168.511





Figura 1 Pamje nga aktiviteti

### 3. PËRSHKRIMI I VEPRIMTARISË

Veprimtaria që do të zhvillohet në këtë instalim klasifikohet në kategorinë “Veprimtari të katranit dhe bitumit”, konkretisht sipas kodit ID 7.3/c, që përfshin procese të ngrohjes dhe përpunimit të bitumit në funksion të prodhimit të materialeve ndërtimore, pa përfshirë proceset e distilimit.

Në këtë kuadër, aktiviteti konsiston në prodhimin e asfaltobetonit për përdorim në ndërtimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës rrugore dhe objekteve të tjera ndërtimore.


### 4. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISË

Projekti parashikon instalimin e një linje teknologjike bashkëkohore për prodhimin e asfaltobetonit me kapacitet prodhimi rreth 65 ton/orë. Impianti është i tipit të lëvizshëm dhe do të vendoset mbi elementë të parapërgatitur betoni, pa realizuar ndërtime të përhershme në truall, çka mundëson çmontimin e tij të plotë në përfundim të përdorimit pa lënë ndikime fizike në territor.

Struktura e impiantit përbëhet nga disa njësi funksionale të integruara, duke përfshirë bunkerët e furnizimit me agregate, sistemin e tharjes dhe ngrohjes së materialeve, ashensorët e transportit të agregateve, sistemin e filtrimit të pluhurave dhe gazrave, mikserin për përzierjen e materialeve, si dhe depozitat për ruajtjen e bitumit dhe materialeve ndihmëse. Operimi i gjithë linjës kontrollohet në mënyrë të automatizuar nga një kabinë qendrore kontrolli.

Teknologjia e përdorur është e një standardi bashkëkohor, e cila siguron efikasitet të lartë prodhimi dhe minimizim të emetimeve në mjedis.





## 5. LËNDËT E PARA DHE FURNIZIMI

Lëndët e para të nevojshme për funksionimin e Linjës Teknologjike të Asfalteve, prodhohen dhe sigurohen nga vetë zhvilluesi i Impiantit. Këto lëndë konsistojnë në rërën e fraksionuar, granilet e fraksioneve të ndryshme që do të përdoren për miksimin e produktit të asfalteve, filleri si material lidhës midis rërës, granilit e bitumit të lëngshëm, bitumi i lëngshëm i depozituar në çisterna të veçanta të cilat janë të pajisura me sistemin automatik të ngrohjes dhe furnizimit të tij në impiant. Këto materiale janë pjesë e produkteve që kompania FLED sh.p.k. prodhon dhe çertifikon në bazë të kushteve teknike të zbatimit e projektimit si dhe EuroCodeve. Kompania FLED sh.p.k. do të vendosë në dispozicion të gjitha elementët e parapërgatitur të nevojshëm për instalimin dhe vendosjen e Impiantit të Përkohshëm e pajisjeve të linjës. Impianti i linjës teknologjike të asfaltobetonit përbëhet nga dy pjesë përbërëse, pjesa e vendosjes edhe Montimit të Pajisjeve, e cila ka për qëllim porosinë e Elementeve montues “Impianti i asfaltit (kapacitet 65 ton/orë) është impiant i lëvizshëm dhe i përkohshëm, i vendosur mbi kubikë betoni të porositur të lëvizshëm me përmasa  $0.8 \times 0.8 \times 1$  m, pa themele betonarme apo ndërtime të përhershme. (Vendosja nuk përbën ndërtim dhe impianti çmontohet plotësisht pa ndërhyrje në truall.)

Edhe Pjesa e Instalimeve të pajisjeve të veçanta të linjës teknologjike, montimin e rampave ngjitëse për furnizimin me agregate të bunkerëve të ushqimit, realizimin e rrugëve të aksesit për funksionimin e linjës, si dhe furnizimin me lëndë të parë inerte të prodhuara nga vetë kompania FLED sh.p.k, e filler të linjës si dhe realizimi i remontit të linjës.

Pjesa tjetër e impiantit përbëhet nga instalimi i pajisjeve të nevojshme për funksionimin e tij siç janë bunkerët e agregatit, tharësi i inertit me ngrohje, ashensorët e agregatit, filtrat e ndotjes nga tymrat, mikseri, fraksionuesi i materialit, Sillosat e filerit, depozitat e bitumit të lëngshëm,



kabina e kontrollit dhe peshores si dhe tubacionet furnizuese së bashku me aksesorët e nevojshëm të linjës.

-Së pari procesi i përgatitjes për Vendosje të impiantit të perkohshëm do të fillojë me rrethimin dhe sistemimin e territorit në të cilin do të instalohet impianti.

-Do të ndërtohen njëkohësisht edhe me instalimin e çdo pajisjeje edhe kanalet e kalimit të tubacioneve furnizuese me material apo kabllot e fuqisë elektrike, për secilën pjesë duke krijuar akses përdorimi, shërbimi dhe furnizimi të tyre.

Duke respektuar radhën e instalimit të pajisjeve teknologjike si fillim do të vendosen bunkerët e agregateve (rërë e granil).

Do të vendosen bazamentet me elemente të parapregatitur të mbështetjes së tharësit të agregateve (qebapit) dhe do të instalohet tharësi në pozicionin e treguar në vizatime.

Procesi i instalimit të ashensorëve dhe dhomës së fraksionimit dhe mikserit të asfaltit do të jetë radha e punës për realizimin e Vendosjes së Impiantit.

Baza e këmbëve të ashensorit dhe mikserit do të jenë të pregatitura më parë me mbi kubikë betoni të porositur të lëvizshëm me përmasa  $0.8 \times 0.8 \times 1$  m, pa themele edhe pa armim.

Gjatë instalimit të ashensorëve dhe mikserit do të realizohet dhe instalimi i tubacioneve të furnizimit me bitum të lëngshëm si dhe me filler për përgatitjen e produkteve të asfaltobetonit. Përgjatë realizimit të proceve të mësipërme, do të vazhdojë puna për Vendosjen e bazës së filtrit të tymrave dhe sillosave të filerit në përputhje me vizatimet e miratuara.

Siç u theksua edhe më lart për çdo pajisje të instaluar do të kihet parasysh gjatë projektimit dhe zbatimit të krijohen mundësi aksesit për shërbim, mirëmbajtje dhe remont të çdo pajisje në veçanti dhe në tërësi të remontit kapital të linjës teknologjike.

Vendosja dhe instalimi i depozitave të bitumit së bashku me ngrohësin e tij do të instalohen në fazën e parafundit të procesit të instalimit të Linjës.

Një rëndësi të veçantë në procesin e instalimit të Linjës teknologjike do të ketë instalimi i kablllove të fuqisë së linjës dhe panelit të komandimit i cili për momentin shoqëron linjën teknologjike, por do t'i kushtohet vëmendje e veçantë lidhjes së çdo pajisje elektrike me këtë panel si dhe radhës së punës e funksionimit të secilës pajisje në veçanti dhe në tërësi.

Për këtë proces punë do të jetë e nevojshme për vendosjen e kablllove lidhëse të kabinës së kontrollit me çdo pajisje elektrike elektromotora, fryrësa, bruxhator, ashensor etj. Këto kablllo do të vendosen në mënyrë të tillë që të evidentohen lehtësisht se cilës pajisje i përkasin dhe cilin drejtim duhet të kenë në skemën e plotë elektrike të Linjës.

Faza e fundit e Vendosjes së Linjës teknologjike ka të bëjë me sistemimin e shesheve të aksesit në impiant të cilat do të shërbejnë për mirëfunksionimin, furnizimin dhe mirëmbajtjen e Linjës Teknologjike.

Do të kemi si përfundim rrugë të aksesueshme sipas funksionit të tyre si dhe sheshe të aksesueshme.

## 6. PROCESI TEKNOLOGJIK

Procesi teknologjik zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të kontrolluar, duke filluar me furnizimin e bunkerëve me agregate, të cilat më pas kalojnë në sistemin e tharjes dhe ngrohjes.



Pas kësaj, materialet transportohen përmes ashensorëve në njësinë e fraksionimit, ku realizohet ndarja sipas madhësisë dhe dozimi i tyre.

Në fazën përfundimtare, agregatet përzihen në mikser me bitumin dhe filler-in, duke prodhuar asfaltbetonin sipas parametrave të kërkuar teknikë. I gjithë procesi monitorohet në mënyrë automatike për të garantuar cilësinë e produktit dhe reduktimin e humbjeve.

## 7. INFRASTRUKTURA DHE LIDHJET

Zona ku do të vendoset impianti disponon infrastrukturë të përshtatshme për funksionimin e tij. Furnizimi me energji elektrike realizohet përmes një kabine ekzistuese me kapacitet 250 kVA, e cila përballon nevojat e linjës teknologjike.

Gjithashtu, zona ka akses të mirë në rrugët ekzistuese, duke mundësuar furnizimin me lëndë të para dhe shpërndarjen e produktit përfundimtar pa krijuar ngarkesë të konsiderueshme në trafikun lokal.

## 8. NDËRTIMI DHE INSTALIMI

Instalimi i impiantit do të realizohet nga vetë stafi i specializuar i kompanisë, duke përdorur makineri dhe pajisje në pronësi të saj. Procesi përfshin sistemimin e territorit, vendosjen e bazamenteve të përkohshme, instalimin e pajisjeve dhe lidhjen e tyre me sistemet elektrike dhe mekanike.

Kohëzgjatja e kësaj faze është parashikuar të jetë rreth 3 muaj, pas së cilës impianti do të vihet menjëherë në funksion.

## 9. KOHËZGJATJA E PROJEKTIT

Impianti është projektuar si një instalim i përkohshëm dhe parashikohet të funksionojë për një periudhë kohore nga 5 deri në 7 vjet, në varësi të kërkesave të tregut dhe nevojave të zhvillimit të sektorit të ndërtimit.

## 10. NDIKIMET NË MJEDIS

Gjatë funksionimit të impiantit mund të gjenerohen ndikime të kufizuara në mjedis, kryesisht në formën e emetimeve në ajër nga procesi i tharjes dhe përzierjes së materialeve, si dhe në formën e zhurmave nga funksionimi i pajisjeve mekanike.

Megjithatë, për shkak të natyrës së përkohshme të instalimit dhe teknologjisë së përdorur, këto ndikime konsiderohen të kontrollueshme dhe brenda kufijve të lejuar nga legjislacioni përkatës.

## 11. MASAT MBROJTËSE

Për të minimizuar ndikimet në mjedis, do të zbatohen masa konkrete, duke përfshirë instalimin e filtrave për kapjen e pluhurave, mirëmbajtjen periodike të pajisjeve, kontrollin e emetimeve dhe menaxhimin e kontrolluar të mbetjeve.



Gjithashtu, do të merren masa për reduktimin e zhurmave dhe për sigurimin e kushteve të sigurta të punës për punonjësit.

## 12. MENAXHIMI I MBETJEVE

Mbetjet që mund të gjenerohen gjatë procesit janë kryesisht inerte dhe do të menaxhohen në përputhje me legjislacionin në fuqi. Materialet e riciklueshme do të ripërdoren, ndërsa mbetjet e tjera do të trajtohen përmes operatorëve të licencuar.

## 13. SIGURIA DHE EMERGJENCAT

Subjekti do të zbatojë të gjitha kërkesat për sigurinë në punë dhe mbrojtjen nga rreziqet industriale. Do të hartohen plane emergjence dhe do të sigurohen pajisjet përkatëse për përballimin e situatave të paparashikuara, si zjarret apo rrjedhjet e mundshme të materialeve.

## 14. PËRPUTHSHMËRIA ME PLANIFIKIMIN

Projekti është në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kuçovë dhe zhvillimin e zonës si një hapësirë me funksion industrial. Ai nuk bie ndesh me politikat e zhvillimit territorial dhe kontribuon në zhvillimin ekonomik të zonës.

## 15. BAZA LIGJORE

1. Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 'Për mbrojtjen e mjedisit', i ndryshuar;
2. Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis', i ndryshuar.
3. Ligji nr.10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër".
4. Ligji nr. 81, datë 04.07.2017 "Për zonat e mbrojtura" i ndryshuar.
5. Ligji nr.10 253, datë 11.3.2010 "Për gjuetinë".
6. Ligji Nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet".
7. Ligji Nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullor", i ndryshuar.
8. Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar.
9. Ligji nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis", i ndryshuar.
10. Ligji nr.155/2020, datë 17.12.2020 "Për ndryshimet klimatike".
11. Ligji nr.27/2016, datë 17.03.2016 "Për menaxhimin e kimikateve".
12. Ligji nr.9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", i ndryshuar.
13. Ligji nr.57/2025, datë 16.10.2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".



14. VKM nr. 686, datë 29.07.2015 ‘Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiave e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore’.
15. VKM nr. 247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.
16. VKM nr.123, datë 17.02.2011 “Për miratimin e Planit Kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis”.
17. VKM nr. 575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
18. VKM nr.418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035”.
19. VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”.
20. VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.
21. VKM nr. 229, datë 23. 04. 2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”.
22. VKM nr.519, datë 30.6.2010 “Parqet Natyror Rajonal”.
23. Vendim Nr. 22, datë 9.1.2008 "Për caktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal"
24. VKM Nr. 1354, datë 10.10.2008 "Per rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor".
25. VKM Nr. 396, datë 21.06.2006 "Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore".
26. VKM nr.897. datë 21.2.2011 “Miratimi i Rregullave për Shpalljen e Zonave të Veçanta të Ruajtjes”.
27. VKM nr. 31, datë 20.01.2016 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit”.
28. VKM nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”.
29. VKM nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit".
30. VKM Nr. 412, datë 19.06.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.
31. VKM nr 352, datë 29.04.2015. “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”.
32. VKM nr.123, datë 17.02.2011 “Për miratimin e Planit Kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis”.
33. Udhëzim i përbashkët nr.2, datë 15.11.2023 “Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomiko-shoqërore”
34. VKM nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.



35. VKM nr.402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.

Ferdi Mearra

